

Data 02.05.2025

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i Procedures: “Mirëmbajtje e dhomës së serverave në Bashkinë Tiranë”

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 983900000-3 (Shërbime të tjera)

Vlera e fondit limit: 5,825,650 (pesë milion e tetëqindë e njëzetë e pesë mijë e gjashtëqindë e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti kontraktor Bashkia Tiranë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, **sipas Shtojcës 3;**
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, **sipas shtojcës 10;**

Kriteret e mesiperme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP i ndryshuar, “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prova paraprake në vend të disa vertetimeve të leshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrimtë subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar,, sidhe shtojcës 9 të DST-së.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit limit që prokurohet, lëshuar nga autoriteti përkatës. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe në nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr.922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

b. Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit (2022,2023, 2024) të paraqitur pranë autoriteteve përkatëse, të konfirmuara nga ky autoritet, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

c. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin për vitin 2024 dhe për kestin përkatës të vitit 2025 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar

sipas QKB. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Shënim: *** Kriteri 2.2.c konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 10. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

a) Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë kontrata të shoqëruara me vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara të nënshkruara nga të dyja palët.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qellim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

3. Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës, realizimin e shërbimeve përkatëse përgjatë periudhës së parashikuar të mirëmbajtjes sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë staf të kualifikuar me kompetencat minimalisht si më poshtë:

- a. 1 (një) specialist të certifikuar ITIL /ose ekuivalente për menaxhimin e proceseve të punës.
- b. 1 (një) inxhinier elektrik për mirëmbajtjen e sistemeve elektrike pjesë e kësaj procedure.
- c. 1 (një) specialist të certifikuar për pajisje UPS.
- d. 1 (një) specialist të certifikuar për pajisje Sistemi i kondicionimit (HVAC).
- e. 2 (dy) specialistë ose teknikë të fushës, të pajisur me kartela të sigurimit teknik nga I.SH.T.I. ose nga institucione ekuivalente.

- 1 (një) specialist të certifikuar ITIL /ose ekuivalente për menaxhimin e proceseve të punës.

Argumentim: Një certifikim ITIL /ose ekuivalente një set praktikash, kuadri rregullash dhe idesh për realizimin e shërbimit në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, që është pjesë e qëllimit të kontratës së autoritetit kontraktor. Kërkesa për certifikim ITIL ose ekuivalente, i garanton ideimin dhe konceptimin e shërbimeve IT të kontratës në mënyrë të menaxhueshme sipas standardeve ndërkombëtare të njohura, në gjithë ciklin e tyre, përfshirë këtu dhe shërbimet e mirëmbajtjes. Kjo kërkesë garanton Autoritetin Kontraktor se Operatori Ekonomik ka në përbërjen aktuale të stafit të tij personel të kualifikuar që ndjek dhe mbikqyr projektet në nivel operacional bazuar mbi standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të menaxhimit të shërbimeve IT.

- 1 (një) inxhinier elektrik për mirëmbajtjen e sistemeve elektrike pjesë e kësaj procedure.

Argumentim: Plotësimi i kësaj kërkesë është garanci për Autoritetin Kontraktor që Operatori Ekonomik ka në përbërje të personelit të tij një punonjës të aftë për të realizuar shërbimet që lidhen me sistemet elektrike ku përfshihen verifikimi teknik i gjendjes së pajisjeve elektrike, panele elektrike, kryerja e pastrimeve të nevojshme, kontrolli i aksesoreve për fiksimin e kabllave të tyre, si dhe instalimin e materialeve, në rast zëvendësimi dhe mirëmbajtje infrastrukturën elektrike, objekt kontrate.

- 1 (një) specialist të certifikuar për pajisje UPS.

Argumentim: Kërkesa për të paktën 1 (një) specialist të certifikuar për pajisjet UPS është në përpjestim dhe e lidhur ngushtë me shërbimet e kërkuara, objekt prokurimi si më poshtë:

Shërbimet ndaj UPS-së

Verifikimi teknik i gjendjes së sistemit të UPS-ve dhe kryerja e pastrimeve të nevojshme, kontrolli i aksesoreve për fiksimin e kabllave dhe kanalave, kontrolli i etiketave, gjendjes së tokëzimeve.

Kontrolli i funksionimit të ventilatorëve.

Testimet dhe kontrolli në veprimin e automatikës (nëse është e mundur).

Kontrolli i ngarkesës dhe gjendjes së baterive.

Plotësimi i kësaj kërkesë është garanci për Autoritetin Kontraktor që Operatori Ekonomik ka në përbërje të personelit të tij një punonjës të aftë për të realizuar shërbimet që lidhen me UPS të markës VERTIV LIEBERT EXS30” 30KVA.

- 1 (një) specialist të certifikuar për pajisje Sistemi i kondicionimit (HVAC).

Argumentim: Plotësimi i kësaj kërkesë është garanci për Autoritetin Kontraktor që Operatori Ekonomik ka në përbërje të personelit të tij një punonjës të aftë për të realizuar shërbimet që lidhen me Sistemin e kondicionimit (HVAC) të markës Vertiv Liebert PDX (PX025/D/A), ku përfshihen

kontrollat periodike sipas manualeve të pajisjes, Verifikime dhe shërbime të përgjithshme, kompresorëve , ventilatorëve, lagështise, gazit, konfigurimet etj.,.

-2 (dy) specialistë ose teknikë të fushës, të pajisur me kartela të sigurimit teknik nga I.SH.T.I. ose nga institucione ekuivalente.

Argument: Kërkesa për 2 (dy) punonjës ose teknik të fushës, të pajisur me kartela të sigurimit teknik, është hartuar mbështetur në nenin 7 të ligjit nr. 13/2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8734 datë 01.02.2001 “Për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe instalimeve elektrike”, ku citohet se:

Përdorimi i pajisjeve elektrike bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie, të lëshuar nga një organ i akredituar certifikues personeli për fushën përkatëse...”

Kjo kërkesë është hartuar në përputhje me objektin dhe volumin e kontratës, në përputhje me termat e referencës së kontratës dhe specifikimeve teknike, objekt kontrate.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

4.Një punësim mesatar i të paktën **6 (gjashtë)** personave, për periudhën të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për minimum 3(tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar si dhe listpagesat e punonjesve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërket nga legjislacioni në fuqi, *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetedeklarimit, këto dokumente do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit).*

Argumentimi: Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bere në përputhje me zerat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve, që është perlllogaritur në një kohë të shkurtër i cili kërkon fuqi punëtore të shtuar dhe me mjetet e kërkuara për zbatimin me sukses të kësaj kontrate

Gjithashtu Njësia e Prokurimit për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore dhe stabilitetin e saj ka kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjesve mbështetur edhe në pikën 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

5.Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ose ekuivalente të tyre të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, të jenë të vlefshme, e që kanë lidhje me objektin e kontratës, si më poshtë:

a. Standardin ISO 9001-2015 për sistemin e menaxhimit të cilësisë, objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 9001-2015 sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.)

b. Operatori ekonomik duhet të jetë i çertifikuar me standardin ISO 27001 për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

(Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 27001, sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.)

Argumentimi:

Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”(i ndryshuar),

“ Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.... ” si dhe në mbështetje të nenit 44, pika 1 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) konkretisht:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

a. ISO 9001-2015 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga operatori ekonomik, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesin e menaxhimit (për furnizim, ofrimin të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e konformitetit për shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e klientëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

Kërkesa për ISO 9001-2015 është një kërkesë e domosdoshme për të garantuar realizimin me sukses të kontratës.

b. ISO 27001 është një kuadër standartizues në lidhje me garancitë që kërkon autoriteti kontraktor nga operatorët ekonomikë në lidhje me :

- mirëmbajtjen e sistemit ISMS (Information Security Management System) brenda vetë organizatës së operatorit ekonomik.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për menaxhimin e risqeve të sigurisë.
- aplikimin e praktikave të sigurisë për trajtimin e të dhënave sensitive.
- aplikimin e masave dhe praktikave të sigurisë për shërbimet e kryera në ambiente sensitive.

Referuar sa më sipër cituar, ky standard i kërkuar, lidhet ngushtësisht dhe drejtpërdrejtë me zërat e kërkuara objekt kontrate, konkretisht:

Objekti kryesor i këtij shërbimi është mirëmbajtja e sistemeve:

- Qëllimi i këtij shërbimi është mirëmbajtja e dhomës së serverave të Bashkisë Tiranë, ku duhet të arrihet:
- Realizimi i të gjitha shërbimeve të nevojshme të mirëmbajtjes për garantimin e funksionimit të plotë dhe efikasitetin e dhomës së serverave, duke evituar/ zgjidhur problemet që mund të shfaqen gjatë periudhës së mirëmbajtjes.

Realizimi i sa më sipër, por jo vetëm, kërkon ndërhyrje në ambiente sensitive të Autoritetit Kontraktor, si rrjedhojë certifikimi ISO 27001 i operatorit ekonomik është një garanci e nevojshme për Autoritetin Kontraktor për aplikimin e praktikave mbi menaxhimin e risqeve, trajtimin e të dhënave dhe shërbimeve që do të kryhen.

Argumentimi i specifikimeve teknike:

*Termat e referencës/ Specifikimet teknike, janë hartuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, si dhe informacionin specifik për shërbimet objekt kontrate, referuar termave të referencës, që përcaktojnë natyrën, objektin, qëllimin dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet